

## Termet dhe Kushtet në Grand Flowers

Ju faleminderit që keni zgjedhur Grand Flowers, vendin ku mund ta gjeni çelësin për ta bërë të lumtur personin e zemrës suaj për çdo rast dhe festë.

Kushtet dhe afatet përcaktojnë marrëdhënien afariste që lidhet nga Grand Flowers dhe Klienti. Ne kemi hartuar këto kushte të përdorimit në mënyrë që të njoftoheni me rregullat të cilat definojnë marrëdhënien tonë me ju. Jemi munduar që kjo rregullore të jetë sa më e kuptueshme, por në të do të hasni edhe terme ligjore. Arsyeja e përdorimit të tyre është se formojnë nenet dhe relacion të detyrueshëm kontraktues ndërmjet juve dhe Grand Flowers kështu që ju lutemi që t'i lexoni me kujdes.

Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga konteksti, për qëllimet e këtyre kushteve, termet e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

**“Ditë pune”** është çdo ditë e vitit përveç vikendeve dhe ditëve të festave zyrtare në Kosovë, në përputhje me Ligjin e aplikueshëm për festat zyrtare.

**“Përdorues”** nënkupton secilin shfrytëzues të platformës dhe në rastin kur përdoruesi blen produkte, ai trajtohet si klient. Për qëllime të këtyre kushteve të përdorimit, termet “përdorues”, “konsumator” dhe “klient” përdoren për të njëjtin kuptim/person.

**“Platformë”** nënkupton faqen online [www.grand-flowers.com](http://www.grand-flowers.com)

**“Produkt”** nënkupton produktin e lejuar për qarkullim në tregun e Kosovës, për të cilin ofruesi është importues i ligjshëm, ka paguar detyrimet tatimore dhe doganore dhe e ka në pronësi të tijën për shitje ndaj palëve të treta.

**“Afatet”** janë limitet kohore që Grand Flowers i vendos për liferim të produktit, pagesë, ndryshim parametrash, anulim të blerjes, kthim të mallit, rimodelim ose të ngjashme.

**“Legjislacion i zbatueshëm”** nënkupton legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë sipas Kushtetutës së Kosovës së qershorit 2008, bashkë me ndryshimet dhe plotësimet.

**“Rimbursim”** nënkupton kthimin e pagesës së klientit për arsyet e përcaktuara në këtë kontratë.

**“Ofruesi”** nënkupton furnitorin e produkteve, i cili të njëjtat i plason, respektivisht ekspozon në platformë.

Tërë përmbajtjen e internetit, duke përfshirë, indikativët/treguesit por pa u kufizuar, markat tregtare, titujt dallues, tekste, fotografi, janë në pronësi të Grand Flowers dhe trajtohen në bazë të dispozitave përkatëse të ligjit të Kosovës për të drejtën e autorit, markën tregtare dhe patentën, në lidhje me pronësinë intelektuale dhe industriale. Rrjedhimisht, nuk është e lejuar në asnjë mënyrë, modifikimi, publikimi, transferimi, riprodhimi, shpërndarja, prezantimi, ose çdo përdorim të përmbajtjes në tërësi ose të pjesëve të faqës së internetit ose me çdo mjet për qëllime tregtare apo të tjera, pa pëlqim paraprak me shkrim nga Grand Flowers. Përrjashtimisht, kopjimi i kufizuar ose i izoluar, printimi ose ruajtja e pjesëve të përmbajtjes së sipërpërmendur është e lejuar për përdorim personal të vizitorit, me kusht që përmbajtja të jetë e shoqëruar me një njohje të qartë dhe të dallueshme të burimit të origjinës dhe me vërtetimin se ajo nuk do të përdoret për qëllime komerciale apo të tjera.

## **Sjellja e përdoruesit**

Platforma dhe të gjitha faqet e internetit të ofruara nga Grand Flowers do të përdoren për qëllime të ligjshme dhe në një mënyrë që mos të kufizoj ose pengoj përdorimin e saj nga ndonjë palë e tretë. Vizitorët/përdoruesit e internetit duhet të jenë në përputhje me rregullat dhe dispozitat e legjislacionit të Republikës së Kosovës dhe të Bashkimit Evropian dhe me legjislacionin që rregullon telekomunikacionet dhe të përmbahen nga çdo sjellje e paligjshme dhe abuzive/papërshtatshme që mund të ketë pasojë negative për vizitorët/përdoruesit e tjerë dhe të shkaktoj dëmtime apo prishje të internetit dhe të shtrihet/afektoj Grand Flowers. Në rast se Grand Flowers e gjenë veten të përfshirë në ndonjë çështje gjyqësore, ose i kërkohet të paguajë ndonjë lloj kompensimi si pasojë e një shkeljeje nga ana e përdoruesve të detyrimeve të tyre, përdoruesi do të kompensoj Grand Flowers në përputhje me rrethanat respektive.

## **Kufizimi i përgjegjësisë**

Grand Flowers bën çdo përpjekje të mundshme për të siguruar që të gjitha informacionet e ofruara nga platforma të jenë të plota, të sakta, të rifreskuara dhe të qarta, por kjo nuk garanton se të gjitha

kriteret do të plotësohen bashkërisht. Rrjedhimisht, Grand Flowers nën asnjë rrethanë, edhe në rast të neglizhencës, nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë gabim ose mangësi, lëshimet në lidhje me dhënien e informacionit, çdo vonesë, ndërprerje ose paaftësi në transmetimin e informacionit apo çfarëdo dëmi të shkaktuar vizitorëve/përdorues për shkak të përdorimit të informacionit të tillë. Përmbajtja e faqes së internetit nuk përbën këshilla financiare, ligjore apo të tjera, nxitje apo iniciative për të kryer një investim apo ndonjë transaksion të mundshëm dhe Grand Flowers në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë përdorim të internetit nga ana e vizitorëve/përdoruesve, të cilët veprojnë të udhëhequr nga vullneti i tyre.

## **Siguria e faqës së Internetit**

Qasja në faqen e internetit mundësohet me nismën e vizitorëve/përdoruesve dhe jo me iniciativën e Grand Flowers. Përdoruesi i faqes së internetit dhe platformës është vetëm përgjegjës për marrjen dhe ruajtjen e pajisjeve të nevojshme (p.sh. kompjuter personal), softuer, pajisjet e telekomunikacionit dhe çdo shërbim tjetër të nevojshme për qasje në këtë faqe interneti. Përdoruesit janë përgjegjës për mbrojtjen e sistemit të tyre kundër viruseve dhe programe të tjera me qëllim të keq, përfshirë ruajtjen e të dhënave të tyre financiare. Grand Flowers bën çdo përpjekje të mundshme për të siguruar që të gjitha masat e sigurisë të jenë marrë për të mbrojtur faqen e internetit dhe platformën kundër viruseve dhe programe të tjera me qëllim të keq dhe përdor sistemet e sigurisë për të kontrolluar qasjen në faqet e saj të internetit, në mënyrë për të parandaluar sulme dhe çdo veprim tjetër të paautorizuar, por ajo nuk garanton se përmbajtja e internetit do të jetë e lirë nga viruset, gabimet dhe komponentë të tjerë të dëmshme dhe për rrjedhojë në asnjë rast nuk do të jetë përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar softuer-ëve, pajisjeve dosjeve të përdoruesve të lartpërmendur, si dhe për çdo dëm të shkaktuar përdoruesit, për ndonjë nga shkaqet e mësipërme.

## **Të dhënat personale**

Grand Flowers do të sigurohet që të gjitha të dhënat personale të grumbulluara nga vizitorët dhe përdoruesit të trajtohen në përputhje me Ligjin Nr. 03/1-172 për mbrojtjen e të dhënave personale.

Grand Flowers nuk grumbullon nga klientët potencial kopje të dokumenteve personale ose çfarëdo dokumenti tjetër. Në rastet kur Grand Flowers dyshon në vërtetësinë e personit dhe porosisë, Grand Flowers mund t'i kërkoj përdoruesit dokument identifikimi personal, të cilin do ta fshij nga baza e të dhënave në momentin që arrihet qëllimi i kryerjes së porosisë nga përdoruesi. Grand Flowers nuk do t'i transferoj të dhënat personale palëve të treta. Në momentin që një palë e tretë vjen deri te kontakti me të dhëna personale të cilat menaxhohen ose mbahen nga Grand Flowers, pala e tretë pajtohet që në lidhje me këto të dhëna personale të veproj në tërësi në përputhje me Ligjin Nr. 03/1-172 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të njëjtat t'i fshij menjëherë duke lajmëruar rastin te Grand Flowers. Për më tepër, vizitorët/përdoruesit e faqeve të internetit të Grand Flowers dhe platforma kanë të drejtë për të hyrë në të dhënat që lidhen me to dhe të drejtë të kundërshtojnë për përpunimin e të dhënave të tilla. Në secilin rast, vizitori mund t'i drejtohet me kërkesë me shkrim përmes email adresës së Grand Flowers për të fshirë të dhënat personale.

## **Politikat, procedurat dhe parimet cookies**

Një “cookie” është një tekst i vogël dosje, i cili është dërguar dhe ruajtur në kompjuterin tuaj ose ndonjë pajisje tjetër që ju mund të përdorni për të hyrë në internet, çdo herë që ju vizitoni një faqe interneti, pa mbledhur asnjë informacion në lidhje me dokumentet apo dosjet në pajisjen tuaj. Grand Flowers përdor “cookies” për shumë arsye të ndryshme, me qëllim të krijimit të një ambienti më të sigurt dhe më efikas për vizitorët/përdoruesit. Grand Flowers kryesisht përdor “cookies”, të cilat janë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të paraqitura nëpërmjet faqes sonë të internetit, po ashtu “Cookies” përdoren për qëllime statistikore dhe çështjet që lidhen me funksionimin e faqes sonë të internetit (p.sh. numri i vizitorëve, kthimi, frekuenca e vizitave, parapëlqimet e përdoruesit etj). Përdoruesit e faqeve të internetit zakonisht janë të ekspozuar para kërkesës për të pranuar “cookies”. Rrjedhimisht, në qoftë se ju dëshironi të ndryshoni mënyrën se si funksionon shfletuesi i juaj i internetit, qoftë për të ju njoftuar në lidhje me përdorimin e “cookies”, ose për të bllokuar “cookies”, ju duhet të ndryshoni parametrat e shfletuesit tuaj te internetit. Duhet të theksohet se mos pranimi i “cookies” mund të kufizoj ofrimin e shërbimeve të caktuara dhe informacioneve nga Grand Flowers.

## **Mënyra e komunikimit**

Ju keni mundësi të zgjedhni se si ne mund të përdorim të dhënat tuaja personale për të komunikuar me ju, për t'ju dërguar njoftime informuese dhe se si ne mund të ju dërgojmë reklama të personalizuar dhe relevante. Ju mund të kontrolloni metodat përmes të cilave ne mund të ju kontaktojmë juve në lidhje me llogarinë tuaj, dhe aktivitetet tuaja të blerjes apo aktivitetet e tjera.

## **Modifikimi i shërbimeve**

Në Grand Flowers, në vazhdimësi përmirësojmë shërbimet ekzistuese, si dhe ofrojmë shërbime të reja, gjë që rezervon të drejtën që në çdo kohë dhe pa ndonjë njoftim paraprak të ndryshoj, përmirësoj, kufizoj ose ndërprej përkohësisht apo përfundimisht ndonjë nga shërbimet/produktet ose pjesë të këtyre shërbimeve/produkteve, apo pjesë të funksioneve të këtyre shërbimeve/produkteve. Gjithashtu, Grand Flowers rezervon të drejtën për të prezentuar apo futur në funksion veçori ose aplikacione të reja për të përmirësuar shërbimet e tona. Kjo do të thotë që mund të shtojmë funksionalitete të reja, produkte apo shërbime, apo t'i ndalim ato. Ne, mund të ndërmarrim cilin do veprim në çfarëdo kohe dhe mund të mos jemi në gjendje t'ju njoftojmë paraprakisht.

## **Vëmendje**

Të nderuar konsumatorë, të gjitha lulet në këtë web faqe janë natyrale (të gjalla), dhe për këtë arsye ndonjëherë në mungesë të ndonjë luleje sezonale, bëhet zëvendësimi me ndonjë lule tjetër të ngjajshme në pamje dhe nuancë. Por gjithsesi kompozimi ose buqeta punohet ngjajshëm si në fotografi dhe me vlerën e cekur për të.

## **Refuzimi apo anulimi i një transaksioni**

Grand Flowers rezervon të drejtën që në çdo kohë, nën vullnetin e saj të lirë, të refuzoj apo të anuloj një transaksion online për çfarëdo arsye. Disa situata që mund të rezultojnë që një transaksion online të refuzohet apo anulohet përfshijnë dyshimet për mashtrim me kartelën e kreditit apo debitit, kur ka arsye të besojmë se transaksioni online është i pa-autorizuar, shkel

ndonjë ligj, rregull apo rregullore. Grand Flowers në çdo kohë mund të kërkoj verifikime ose informacione shtesë për ndonjë transaksion online.

## **Kujdesi ndaj klientit**

Kujdesi ndaj klientit ka një rëndësi të veçantë për ne. Nëse ju keni nevojë për ndihmë apo asistencë për procesim të ndonjë transaksioni, ju keni mundësi që të lidheni drejtpërdrejtë me ne, përmes numrit kontaktues dhe/ose email adresës sonë.

## **Orari për porosi**

Ju informojmë që porositë online procesohen në këtë orar e Hënë – Shtunë, nga ora 08:00 – 18:00, ndërsa porositë e bëra në ditën e dielë procesohen të hënë.

## **Tatimet**

Çmimi i produkteve apo shërbimeve të listuara në web faqen tonë përfshinë TVSH-në.